

VENDIM
Nr.72, datë 14.12.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“	“
Zija Vuci,	Anëtar i	“	“
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“	“
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto,	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“	“
Hajredin Fuga,	Anëtar i	“	“

me sekretare Noela Ruço, më datë 10.11.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.66 Akti që i përket:

KERKUES :ARBEN SHEHU

SUBJEKT I INTERESUAR: INSIG, DEGA DIBËR, përfaqësuar nga Alban Brati dhe Ramadan Hoxha.

OBJEKTI:

Deklarimin antikushtetues të vendimit nr.672, datë 31.1.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, bazuar në nenet 38, 40 dhe 27 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata e Kasacionit ka tejkaluar kompetencat që i njeh Kodi i Procedurës Civile. Sipas nenit 485 të këtij Kodi, kolegji civil nuk ka të drejtë të shqyrtojë çështjen në themel dhe të gjykojë në fakt, duke prishur të dy vendimet, si atë të gjykatës së faktit dhe të shkallës së dytë.

- Çështja është gjykuar në Kasacion më 24.7.1996, në prani të palëve, por si rezultat i ndërhyrjeve, vendimi është shpallur më 31.1.1997. Kjo zvarritje e qëllimshme, vjen në kundërshtim me nenin 40 të Ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, që parashikon zhvillimin e një procesi të drejtë të paanshëm dhe të shpejtë.

- Pala e paditur INSIG-u, dega Dibër, nuk ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Kasacionit. Në kundërshtim me ligjin rekursi është paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë Motorike pranë INSIG-ut, pa qenë i autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e kërkuesit dhe të përfaqësuesve të subjekti të interesuar si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Shkaqet e parashtruara nga kërkuesi për deklarimin antikushtetues të vendimit nr.672, datë 31.1.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, nuk qëndrojnë, për rrjedhojë, kërkesa duhet rrëzuar.

Rezulton e vërtetë se kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.672, datë 31.1.1997 ka prishur si vendimin nr.1221, datë 21.11.1995 të gjykatës së rrethit Dibër, ashtu edhe vendimin nr.250, datë 21.1.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj. Sipas nenit 7 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, që ishte në fuqi në kohën e dhënies së vendimit, Gjykata e Kasacionit “...shqyrton vetëm bazën ligjore të vendimeve gjyqësore që i paraqiten në rrugë kundërshtimi ose që i tërheq vetë“. Në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, megjithëse ka rrëzuar padinë, në rastin konkret ka shqyrtuar bazueshmërinë në ligj të vendimeve të ankmuara, detyrë funksionale kjo e Gjykatës së Kasacionit, e cila duke i gjetur ato në kundërshtim me ligjin i ka prishur për këtë shkak, Në këtë vështrim, ky

veprim, i parë në harmoni me detyrën funksionale të Gjykatës së Kasacionit, nuk e bën procesin jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Përderisa me vendimet e ankimuara, siç ka konkluduar kolegji civil, nuk është zgjidhur drejt çështja, sepse të dy gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin, prishja e vendimeve dhe dërgimi i çështjes për rigjykim, vetëm që të zbatohet drejt ligji, do të përbënte një formalitet krejtësisht të panevojshëm që do të shoqërohej me pasoja negative për përfundimin e saj. Do të ndodheshim para një procesi jo të rregullt ligjor në këtë rast poqese kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit do të prishte të dy vendimet dhe do të vendoste vetë për çështjen, duke bërë vlerësim të ndryshëm të provave apo do ta bazonte vendimin në prova të paadministruara në dy shkallët e gjykimit, ose poqese çështja do të kishte nevojë për të marrë prova të tjera, sepse po të ndodhte kështu, Gjykata e Kasacionit do të vepronte në kundërshtim me detyrën funksionale të saj, si instanca më e lartë gjyqësore që kontrollon bazueshmërinë në ligj të vendimeve të gjykatave më të ulta.

Sikurse rezulton nga dosja, rekursi i paraqitur në Gjykatën e Kasacionit është nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë Motorike, që mbulon këtë sektor dhe mban vulën e INSIG-ut. Sipas ligjit nr.7506, datë 31.7.1991 “Për Institutin e Sigurimeve”, ky institucion drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe me autorizim të tij mund të përfaqësohet edhe nga persona të tjerë. Ndonëse në rastin konkret, rekursi nuk është paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm, por nga Drejtori i Drejtorisë Motorike, gjë që përbën një parregullsi, paisja e këtij të fundit me një autorizim nga organi drejtues për ta përfaqësuar në gjykim këtë institucion në Gjykatën e Kasacionit, në vetvete përbën edhe një miratim të rekursit të nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë Motorike. Ndryshe, poqese organi drejtues nuk do të ishte dakord me rekursin e paraqitur ndaj vendimeve të ankimuara, ai nuk do të jepte autorizim për përfaqësim në gjykimin e kësaj çështje. Duke e parë problemin në këtë këndvështrim, dhënia e autorizimit shpreh njëkohësisht vullnetin e organit drejtues si për ushtrimin e rekursit, ashtu edhe për përfaqësimin në gjykim dhe për rrjedhojë parregullsia e lejuar nuk mund të shërbejë si shkak që e bën të cenueshëm vendimin e kolegjit civil nga pikëpamja kushtetuese.

Në kërkesën e paraqitur nga kërkuesi pretendohet se është shkelur neni 40 i ligjit për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, sepse gjykimi është zhvilluar më datën 24.7.1996 dhe vendimi është shpallur më 31.1.1997. Kjo zvarritje e pretenduar nga kërkuesi nuk përbën shkelje të parimit kushtetues për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të shpejtë. Në fakt gjykimi i çështjes është zhvilluar në datën e caktuar dhe vetëm shpallja e vendimit me vonesë, nuk ka ndikuar në drejtësinë e vendimit dhe objektivitetin e gjykimit, prandaj edhe ky pretendim nuk përbën shkak që vendimi i kolegjit civil të deklarohet antikushtetues.

Në kërkesë, gabimisht është përmendur neni 485 i Kodit të Procedurës Civile, sepse rekursi në Gjykatën e Kasacionit është regjistruar para hyrjes në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Civile dhe sipas nenit 619 të këtij Kodi, shqyrtimi i rekursit bëhet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të mëparshëm, prandaj edhe kërkesa duhet mbështetur në dispozitat e këtij Kodi. Megjithatë, kjo pasaktësi nuk përbën ndonjë rrethanë esenciale që ndikon në zgjidhjen e çështjes, sepse të dy Kodet përsa i përket qëndrimit që mbahet nga kolegji civil më rastin e shqyrtimit të ankimeve, parashikojnë të njëjtat rregulla.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 9 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.